



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.428/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, të paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 09.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesat e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane(PLE), me seli në Prishtinë, , të ushtruara kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës me Anr.428/2025, Anr.429/2025, Anr.430/2025 të datës 07.02.2025 seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar me numër Anr.428/2025, Anr.429/2025, nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK).

Në ankesën Anr.428/2025, pretendohet se me datë 5 shkurt 2025, më orën 19:05 në rrjetin social në facebook një mbështetës i subjektit politik IRDK me llogarinë e tij “Bedre Boss”, ka publikuar një video dhe ka shënuar numrin identifikues “111 IRDK”, më të cilin ky subjekt politik garon në zgjedhje si dhe tekstin “*Pi lypin kta të Ple.s ni puntorë për pula kush asht i interesum*”.Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi.

Në ankesën Anr.429/2025 pretendohet se më 5 shkurt 2025, në orën 19:00, në rrjetin e tij social në facebook,kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik IRDK,z.Idriz Murtezi, Isa Mala,Abedin Neziraj kanë shpërndarë një fotografi të një vajze,por objekt i kësaj ankese është pjesa e tekstit “*Çka pamë në këtë javë:Në PLE aderon “lumi” ndërsa ministri Krasniqi e siguron ujin e pijes për krejt Fushë Kosovën: “Luanët dhe tigrat” masin puls në mes vete ndërsa ministri Krasniqi mban tubime historike në secilën komunë e secilin rajon*”. Parashtruesi i ankesës po ashtu thekson se në mënyrë të qartë

kandidati për deputet z.Murturi ka ironizuar dhe berë shaka duke thënë se *“Luanët dhe tigrat” masin puls në mes vete (i referohet veprimin të një kandidati për deputet nga PLE z.Suad Ademi i cili ditë më parë ka mbajtur fjalim rasti ku ka ilustruar veprimin që do të bëjë matjen e pulsit).*Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi ku shihen mbishkrimi.

Në përgjigjen për ankesën Anr.429/2025 te paraqitur në PZAP me datë 08.02.2025 subjekti politik IRDK ka theksuar se i njëjti pretendim nuk qëndron pasi që Idriz Murtezi etj ka përdorur diskursin politik për promovimin e punës së IRDK-së si dhe diskursin ironik për kundërshtarin politik, duke përçuar patjetër mesazh politik, por që nuk mund të interpretohet në asnjë menyre si gjuhë urrejtje apo nxitëse për urrejtje.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.428/2025, A.nr.429/2025, A.nr.430/2025 të paraqitura me datë 07.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.428/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik PLE kundër subjektit IRDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesat janë të pabazuara.

Për faktin se pas shikimit të shkresave të ofruara si prova materiale nga ankuesi, shihet një mbështetës i subjektit politik IRDK me llogarinë e tij “Bedre Boss”, ka publikuar një video dhe ka shënuar numrin identifikues “111 IRDK”, më të cilin ky subjekt politik garon në zgjedhje si dhe tekstin *“Pi lypin kta të Ple.s ni puntorë për pula kush asht i interesum”*, kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik IRDK, z.Idriz Murtezi, Isa Mala, Abedin Neziraj kanë shpërndarë një fotografi të një vajze, por objekt i kësaj ankese është pjesa e tekstit *“Çka pamë në këtë javë: Në PLE aderon “lumi” ndërsa ministri Krasniqi e siguron ujin e pijes për krejt Fushë Kosovën: “Luanët dhe tigrat” masin puls në mes vete ndërsa ministri Krasniqi mban tubime historike në secilën komunë e secilin rajon.* Keshtu që sipas vleresimit të panelit deklaratimet e tilla, janë një paraqitje e pikepamjeve individuale të mbështetës dhe kandidatëve, të njëjtat nuk shfaqin urrejtje dhe nuk mund të quhet nxitëse andaj nuk bie në kundërshtim me nenin 34. Pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.”,

Dhe duke i vlerësuar këto deklaratime mbështetës dhe kandidatëve të IRDK, Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe të urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Fjalimet e tilla të përdorura nga mbështetësi dhe kandidatët e IRDK konsiderohen se hyjnë në diskursin e fushatës zgjedhore, dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave të tjerë ose pasurisë,

Andaj paneli vlerëson se deklaratimet e lartcekura nga ana e kandidatëve nuk konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), e LZP-së, në të cilin nen përcaktohet se *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.428/2025, datë 09.02.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardhi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.